



Funded by
the European Union



*Trajtimi institucional
i rasteve të korrupsionit:*

Sfidat e sistemit
gjyqësor gjatë një viti



Group for Legal
and Political
Studies

Group for Legal and Political Studies
"Rexhep Luci" str. 16/1
Prishtina 10 000, Kosovo
Website: www.legalpoliticalstudies.org
E-mail: office@legalpoliticalstudies.org
Tel/fax.: +381 38 234 456

Trajtimi institucional
i rasteve të korrupsionit:
**Sfidat e sistemit
gjyqësor gjatë
një viti**

ACT NOW -

Përkrahja e Reformës së Administratës
Publike dhe Sundimit të Ligjit
përmes Luftimit të Korrupsionit dhe
Përmirësimit të Ofrimit të Shërbimeve

*Autore: Dea Fetiu**

*Kontribues: Arton Hoxha, Elvana Hatashi, Gentril Kuqani,
Jon Ramadani, Leotrim Pajaziti, Leostina Maloku, Rina Murseli*

*Verzioni origjinal i këtij raporti
është i shkruar në gjuhën angleze

**Ky botim është arritur me mbështetjen
financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja
e tij është përgjegjësi e vetme e GLPS-
së dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht
pikëpamjet e Bashkimit Evropian

Përmbajtja:

Përmbledhje ekzekutive	5
Hyrje	6
Metodologjia	7
Kapitulli 1. Rezultatet e Monitorimit të Seancave Gjyqësore: Një Vit në Shqyrtim	8
Kapitulli 2. Rezultatet e Monitorimit të Aktgjykimeve	11
2.1. Gjetjet e Përgjithshme nga aktgjykimet e Monitoruara	11
2.2. Ndërlidhja në mes të Kohëzgjatjes së Procedurës dhe Treguesve të Tjerë	13
2.3. Masat ndëshkuese	15
Kapitulli 3. Rastet e profilit të lartë	17
Rekomandimet:	19

Përmbledhje ekzekutive

Një nga komponentët e rëndësishëm të projektit "Act Now", i iniciuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe i financuar nga BE-ja, ka për qëllim monitorimin e sistemit gjyqësor në Kosovë, veçanërisht trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Ky raport trajton gjetjet nga seancat gjyqësore dhe vendimet e monitoruara nga periudha 1 prill 2023 deri më 31 mars 2024, përkatësisht bën vlerësimin e efikasitetit të gjykatave në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe identifikon fushat që kanë nevojë për përmirësim.

Mbledhja e të dhënave është bërë përmes dy proceseve kryesore: monitorimit të seancave gjyqësore dhe aktgjyqimeve të publikuara. Seancat gjyqësore janë monitoruar në pesë gjykata themelore, me prioritet ishin rastet e korrupsionit të profilit të lartë. Më saktësisht janë monitoruar gjithsej 458 seanca, 322 të mbajtura dhe 127 të shtyera apo të anuluar. Gjithashtu, janë analizuar 143 aktgjyqime të publikuara në ueb faqen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Gjetjet kryesore:

- Numri i lartë i seancave të anuluar apo të mbajtura me vonesë, kontribuon ndjeshëm në zvarritjen e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit.
- Arsyeja kryesore e këtyre vonesave është mosparaqitja e palëve në gjykim.
- Ka shumë raste kur të pandehurit nuk paraqiten në seanca. Për kundër kësaj, gjykatat kryesisht neglizhojnë lëshimin e urdhrave të arrestit ndaj të pandehurve që nuk prezentojnë, pavarësisht mandateve ligjore.
- Mosefikasiteti në shpërndarjen e shkresave të lëndës nga prokuroria ose mosmarrja e tyre nga ana e mbrojtjes shkakton shtyerje apo anulim të seancave. Për më tepër, avokatët mbrojtës shpesh përdorin taktika procedurale për të shtyer procedurat, duke përfshirë kërkesat e paarsyeshme dhe ndryshimet e shpeshta. Janë identifikuar çështje teknike dhe administrative që mund të parandalueshme, të tilla si mungesa e personelit kyç dhe planifikimi i dobët, seanca të mëtejshme të mbajtura me vonesë.
- Gjatë procesit të monitorimit janë vërejtur ndryshime të bëra nga gjyqtarët në lidhje me respektimin e afateve procedurale dhe paragjyqime në trajtimin e përfaqësuesve ligjorë.
- Gjatë kohës monitoruese Prishtina kishte numrin më të madh të aktgjyqimeve të publikuara (43), e ndjekur nga Mitrovica dhe Gjilani (25). Vepra më e shpeshtë e korrupsionit ishte "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar", i hasur në 63 aktgjyqime.
- 88 për qind e aktgjyqimeve nuk specifikojnë pasurinë e sequestruar apo konfiskuar.
- Kohëzgjatja mesatare për zgjidhjen e rasteve të korrupsionit ishte 688 ditë, me një procedurë tipike që zgjat 486 ditë. Janë vërejtur disa variacione rajonale, Prishtina kishte kohëzgjatjen tipike më të gjatë të procedurës, mesatarisht 633 ditë.
- Procedurat më të gjata kishin të bëjnë me aktgjyqime liruese ose refuzuese, ndërsa procedurat më të shkurtra përfunduan me aktgjyqime dënuese.
- Rastet që përfshinin shkelje të shumta kishin gjithashtu kohëzgjatje më të gjatë.
- Nga 143 aktgjyqime, 89 rezultuan me aktgjyqime dënuese me gjobë që ishte forma më e përhapur e dënimit kryesor. Megjithatë, dënimet plotësuese, si ndalimet për ushtrimin e funksioneve publike, janë aplikuar rrallë.
- Janë analizuar katër raste të profilit të lartë. Kohëzgjatja e zgjatur e këtyre rasteve, shpallja e pafajësisë për shkak të provave të pamjaftueshme dhe dënimet minimale në raste të rënda nxjerrin në pah joefikasitetin në procesin gjyqësor dhe problemet e mundshme me udhëzimet e dënimit.

Hyrje

Si përgjigje ndaj nevojës së vazhdueshme për përfshirje aktive të shoqërisë civile në proceset monitoruese që shihen si një akt i përpjekjeve të institucioneve publike kundër korrupsionit, Grupi për Studime Ligjore dhe Politike (GLPS) inicioi projektin e financuar nga BE me emrin "Act Now", nismë kjo në kuadër të së cilës një nga komponentët kryesorë përfshin edhe monitorimin e rregullt gjyqësor në disa nga Gjykatat Themelore të Kosovës. Ky aktivitet është përqëndruar kryesisht në analizimin e mënyrës së trajtimit të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar nga sistemi gjyqësor, me fokus të veçantë ndaj rasteve të korrupsionit të profilit të lartë. "Act Now" ka për qëllim mbështetjen e sundimit të ligjit dhe të përpjekjeve kundër korrupsionit, përmes monitorimit sistematik dhe duke u angazhuar drejtpërdrejt në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës institucionale, dhe njëkohësisht duke rritur efikasitetin në luftën kundër korrupsionit, si dhe konfiskimin dhe menaxhimin e aseteve kriminale.

Ky raport vjetor i vlerësimit paraqet gjetjet e GLPS-së nga monitorimi i seancave gjyqësore dhe vendimeve gjyqësore për periudhën 1 prill 2023 deri më 31 mars 2024. Raporti si i tillë ka dy qëllime kryesore. Së pari, synon të paraqesë të dhënat e nxjerra nga monitorimi sistematik, duke vlerësuar efikasitetin e gjykatave në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Nëpërmjet kësaj analize, identifikohen tendencat dhe modelet në zhvillim, duke siguruar kështu njohuri mbi efektivitetin e reagimeve gjyqësore ndaj korrupsionit. Së dyti, raporti synon të nxjerrë në pah fushat për përmirësim, bazuar në tendencat dhe modelet e identifikuar. Kjo qasje e dyfishtë mundëson një ekzaminim gjithëpërfshirës të efikasitetit të gjykatave dhe faktorëve kontribues të këtij efikasiteti, duke synuar mbështetjen e një vendimarrjeje të mirinformuar, në përpjekjen e vazhdueshme për të luftuar korrupsionin.

Raporti është i strukturuar në tre kapituj. **Kapitulli i parë** paraqet gjetjet dhe tendencat kryesore që rrjedhin nga procesi i monitorimit gjyqësor, duke eksploruar efikasitetin e procedurave gjyqësore dhe modelet e shfaqura në rastet e korrupsionit. **Kapitulli i dytë** fokusohet në monitorimin e vendimeve të publikuara, duke theksuar joefikasitetin, vonesat procedurale dhe politikat ndëshkuese që ndikojnë në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit. Së fundi, **kapitulli i tretë** paraqet statistikën nga katër raste të profilit të lartë, të cilat rezultuan me gjykime të shkallës së parë gjatë periudhës së monitorimit, duke ofruar njohuri mbi efektivitetin e gjykatës në trajtimin e rasteve komplekse të korrupsionit si dhe mbi tendencat e tjera të vërejtura.

Metodologjia

Mbledhja e të dhënave gjatë procesit të monitorimit është bërë përmes dy proceseve të ndara: monitorimit të seancave gjyqësore, dhe monitorimit të vendimeve të publikuara. Të dyja këto procese përfshijnë procedura specifike dhe metoda të mbledhjes së të dhënave, detajet e të cilave janë përshkuruar më poshtë.

Së pari, monitorimi i seancave të korrupsionit dhe krimet të organizuar në gjykata ka filluar më 1 korrik 2023, dhe ka zgjatur deri më 31 mars 2024. Në vazhdimësi janë monitoruar Gjykatat Themelore të Prishtinës, Pejës dhe Gjakovës, ndërsa Gjykatat Themelore të Gjilanit dhe Ferizajt janë monitoruar për një kohëzgjatje prej pesë muajsh. Pesë zyrtarë monitorues nga projekti "Act Now" kanë mbikëqyrur me kohë të plotë seancat gjyqësore, çdo ditë. Gjatë gjithë kësaj periudhe janë monitoruar 458 seanca, 322 të zhvilluara dhe 127 të shtyera apo anuluar. Rastet e korrupsionit të profilit të lartë janë monitoruar me prioritet të lartë. Të dhënat statistikore u mblodhën duke përdorur një formë të standardizuar të mbledhjes së të dhënave, që plotësohej rregullisht me të gjetura cilësore nga një fokus grup me zyrtarë monitorues në fund të periudhës.

Gjithashtu, zyrtarët monitorues kanë monitoruar të gjitha aktgjykimet e publikuara në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KÇJK) për këtë periudhë vlerësimi. Fokusi ishte në aktgjykimet e publikuara gjatë kësaj periudhe, dhe rrjedhimisht jo tek të gjitha aktgjykimet e nxjerra brenda kornizës kohore. Gjithsej 143 vendime për veprat penale të korrupsionit u publikuan gjatë këtij afati kohor, të gjitha të monitoruara rregullisht nga "Act Now". Mbledhja sistematike e të dhënave dhe kodimi në një bazë të dhënash u plotësuan po ashtu me komente kualitative.

Së fundi, katër raste të profilit të lartë rezultuan me gjykime të shkallës së parë gjatë kësaj periudhe monitorimi. I gjithë informacioni u mblodh nga: seancat e monitorimit, aktakuzat, dhe mbulimi mediatik, për të ofruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse të këtyre rasteve.

Për qëllime të këtij raporti, veprat e korrupsionit janë përkufizuar sipas Kapitullit 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK), i cili përshkruan 17 vepra të ndryshme të korrupsionit. Këtu përfshihen: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar (Neni 414), Shpërdorimi dhe mashtrimi në prokurimin publik (Neni 415), Keqpërdorimi i informacionit zyrtar (Neni 416), Konflikti i interesit (Neni 417), Shpërdorimi në detyrë (Neni 418), Mashtrimi në detyrë (Neni 419), Shfrytëzimi i paautorizuar i pasurisë (Neni 420), Marrja e ryshfetit (Neni 421), Dhënia e ryshfetit (Neni 422), Dhënia e ryshfetit zyrtarëve të huaj publikë ose personave zyrtarë të huaj (Neni 423), Tregtimi i ndikimit (Neni 424), Nxjerrja e vendimeve gjyqësore të kundërligjshme (Neni 425), Zbulimi i sekretit zyrtar (Neni 426), Falsifikimi i dokumenteve zyrtare (Neni 427), Mbledhja dhe pagesa e paligjshme (Neni 428), Përvetësimi i paligjshëm i pasurisë gjatë kontrollit ose ekzekutimit të një vendimi gjyqësor (Neni 429) dhe Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave dhuratave, përfitimeve të tjera materiale ose detyrimeve financiare (Neni 430). Krimi i organizuar përkufizohet sipas Nenit 227 të KPRK-së.

Kapitulli 1.

Rezultatet e Monitorimit të Seancave Gjyqësore: Një Vit në Shqyrtim

Ky kapitull synon të analizojë rezultatet e monitorimit të seancave gjyqësore nga GLPS gjatë periudhës 1 korrik 2023 - 31 mars 2024. Pjesa e parë e kapitullit ofron një pasqyrë të seancave të monitoruara, duke përfshirë numrin e përgjithshëm të seancave të vëzhguara, sasinë e këtyre seancave për rastet e korrupsionit dhe krimin të organizuar, dhe raportin e seancave që janë zhvilluar sipas planifikimit kundrejt atyre që janë anuluar ose vonuar. Në pjesën e dytë trajtohen faktorët që kontribuojnë në anulimin dhe vonesën e seancave, duke nxjerrë në pah çështjet sistematike brenda sistemit gjyqësor. Për më tepër, ai shqyrton mospërputhjet e vërejtura gjatë seancave të zhvilluara.

Brenda këtij afati kohor, GLPS monitoroi gjithsej 458 seanca gjyqësore. 394 seanca kanë qenë për vepra penale nga kapitulli i korrupsionit në KPRK dhe 64 janë për krimin e organizuar. Nga këto seanca, 322 janë zhvilluar sipas planit, ndërsa 127 janë anuluar ose vonuar.

	Numri i seancave të monitoruara	Numri i seancave të anuluar/të shtyera	Numri i seancave të zhvilluara
Gjithsej	458	127	322
Korrupsioni	394	107	289
Krimi i organizuar	64	20	33

Numri i lartë i seancave të anuluar apo të vonuara gjatë kësaj periudhe, kontribuon ndjeshëm në zvarritjen e rasteve të korrupsionit në gjykata, të cilat më në fund rezultuan në mesatarisht **688** ditë për zgjidhjen e një çështjeje.¹ Arsyeja kryesore e këtyre zvarritjeve është mosparaqitja e palëve në gjykim. Këtu përfshihen personat e akuzuar, përfaqësuesit ligjorë të mbrojtjes, prokurori, ekspertët apo dëshmitarët. Ndërsa ka shumë rrethana të arsyeshme dhe të pashmangshme në të cilat seancat janë anuluar, një numër i madh i seancave të anuluar rrjedhin nga faktorë të shmangshëm, siç shtjellohet në paragrafin vijues.

Së pari, ekipi Act Now ka vëzhguar një model ku **gjykata neglizhon nxjerrjen e urdhrave të arrestit për të pandehurit që mungojnë në seanca**. Përkundër dispozitave të përcaktuara në Nenin 302 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në vijim: KPPRK), i cili urdhëron lëshimin e urdhrave të arrestit për të pandehurit që mungojnë² është vërejtur se gjykata nuk ka lëshuar urdhra arresti në shumë raste kur personat e akuzuar nuk janë paraqitur në procedurë.³ Për më tepër, ka edhe raste të mungesës së përsëritur të personave të akuzuar.⁴ Numri i konsiderueshëm i seancave të dështuara për shkak të mungesës së personave të akuzuar pengon efikasitetin e gjykatave në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit. Për më tepër, ai ngre shqetësime në lidhje me zbatimin dhe respektimin e procedurave ligjore brenda sistemit gjyqësor.⁵

Së dyti, në shumë raste, **dështimi i seancave gjyqësore ndodh për shkak të mungesës së shkresave të lëndës që duhet t'i ofrohen mbrojtjes nga prokuroria**. Kjo situatë vjen si pasojë e shpërndarjes joefikase të shkresave të lëndës nga prokuroria ose mospërputhjet të dokumenteve të nevojshme nga ana e mbrojtjes.⁶ Janë raportuar disa raste ku palët kanë kërkuar shtyrjen e seancave, me pretendimin se nuk kanë marrë shkresat e lëndës, të nevojshme për rastin. Për më tepër, ndërprerjet ndodhin kur

1 Shih Kapitullin 2

2 KPPRK, Neni 302. E qasshme në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/8750FE73-BA51-463C-BA88-31D0B8865840.pdf>

3 Fokus grupi i mbajtur me zyrtarët e monitorimit më 15 prill 2024

4 Po aty.

5 Fokus grupi i mbajtur me zyrtarët e monitorimit më 15 prill 2024

6 Po aty.

avokatët mbrojtës ndërrohen pa komunikim të duhur, duke rezultuar në përgatitje dhe koordinim të dobët.⁷ Duke marrë parasysh se mbrojtja nuk mund të vazhdojë apo të prezantoj rastin pa qasje në shkresat kryesore siç është aktakuza, mbajtja e një seance gjyqësore bëhet jopraktike. Këto arsye të shmangshme dhe shumë teknike për dështimet e seancave tërheqin vëmendjen për të metat sistematike që pengojnë procesin gjyqësor dhe efikasitetin e gjykatave, veçanërisht në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Çështje të tilla jo vetëm që pengojnë trajtimin në kohë të çështjeve, por edhe besimin e publikut në drejtësinë dhe efektivitetin e sistemit ligjor.

Së treti, ka shumë raste kur **mbrojtja tenton të zgjasë procedurat duke anuluar seancat, potencialisht për të zgjatur afatet kohore ose për të përfituar nga parashkrimet e mundshme dhe për të shmangur një vendim të formës së prerë**. Në shumë raste të profilit të lartë të monitoruara nga GLPS, janë vërejtur skenarë të ngjashëm, duke përfshirë avokatët mbrojtës që bëjnë kërkesa të paarsyeshme të cilat e pengojnë procedimin tutje. Për më tepër, këto kërkesa shpesh vijnë me vonesë të paarsyeshme gjatë procesit, ku janë vërejtur edhe kërkesa të shumta për përjashtimin e gjyqtarëve.⁸ Në të kundërtën, ndërsa KPPRK-ja përcakton afatin për trajtimin e këtyre kërkesave nga organet kompetente,⁹ u konstatua se në disa raste nuk respektohen afatet, duke e zgjatur më tej procedurën. Ndërsa është thelbësore të pranohet se të gjitha palët kanë të drejtë të kërkojnë skualifikim¹⁰ si komponent themelor i një gjykimi të drejtë, gjetjet e monitorimit tregojnë se këto kërkesa ndonjëherë shfrytëzohen për të zgjatur në mënyrë të padrejtë procedurat. Prandaj, është thelbësore që kërkesat e tilla të priorizohen dhe të trajtohen me kohë nga organet kompetente për të parandaluar vonesat e panevojshme.

Së katërti, **disa seanca gjyqësore u ndërprejnë për shkak të çështjeve teknike që mund të parandaloheshin**. Për shembull, në një rast, një individ person në paraburgimi ndaluar nuk mund të transportohej në gjykatë sepse punonjësi policie policisë përgjegjës për transferimin ishte në pushim dhe nuk ishte zëvendësuar. Kjo çoi në anulimin e seancës. Për më tepër, ka pasur raste kur gjyqtarët caktonin seancat për ditën e nesërme, duke e ditur se do të dështonin, pasi kryerja e detyrave të nevojshme brenda një dite ishte e pamundur. Këta shembuj nxjerrin në pah joefikasitetin në procesin gjyqësor që ngadalësojnë proceset gjyqësore dhe kontribuojnë në vonesat e administrimit të drejtësisë.

Megjithatë, edhe gjatë seancave të mbajtura rregullisht, mospërputhje në procedurë janë evidente, të cilat përfundimisht pengojnë efikasitetin e gjykatave në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit.

Së pari, "Act Now" ka identifikuar disa **raste të qasjes së anshme nga gjyqtarët ndaj përfaqësuesve të ndryshëm ligjorë gjatë procedimit**.¹¹ Këto qasje manifestohen me ndarje të pabarabartë të kohës ndërmjet palëve ose në trajtim dhe vëmendje të pabarabartë, ku disa përfaqësues ligjorë gëzojnë respekt më të madh nga gjyqtarët se të tjerët.¹² Ndërsa nuk ka ende asnjë tregues për vendime të njëanshme, për sa i përket periudhës së shkurtër të monitorimit, është e rëndësishme të mbahet parasysh parimi i paanshmërisë,¹³ si parim themelor i procedurave gjyqësore. Në këtë drejtim, të dhënat nga seancat e fokus grupeve zbulojnë raste kur gjyqtarët shfaqin paragjykime bazuar në faktorë të tillë si mosha ose origjina gjeografike. Avokatët më të rinj, për shembull, mund të paragjykojnë padrejtësisht nga gjyqtarët që vënë në dyshim kompetencën e tyre.¹⁴ Në mënyrë të ngjashme, në disa rajone, avokatët nga qytetet e tjera mund të jenë subjekt i respektit të pabarabartë, me gjyqtarë të rajoneve të caktuara që tregojnë më pak konsideratë ndaj tyre.¹⁵ Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk janë vërejtur dallime gjinore apo paragjykime në trajtimin e përfaqësuesve ligjorë, megjithatë, është e rëndësishme të pranohet prezenca e mundshme e paragjykimeve të pavetëdijshme gjinore që mund

7 Po aty.

8 Po aty.

9 KPPRK, Neni 41. E qasshme në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/8750FE73-BA51-463C-BA88-31D0B8865840.pdf>

10 Po aty. Neni 40

11 Po aty.

12 Po aty.

13 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 31 dhe Neni 102(2). E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

14 Fokus grupi i mbajtur me zyrtarët e monitorimit më 15 prill 2024

15 Po aty.

t'a ndikojnë ende dinamikën e sallës së gjyqit.¹⁶ Për më tepër, kjo anësi ka potencialin të ndikojë në vendime të marra në mënyrë të njëanshme, gjë që do të ulte më tej besimin në proceset gjyqësore. Për më tepër, paragjykime të tilla minojnë ndjeshëm parimin e gjithëpërfshirjes, i cili është thelbësor për zhvillimin e një sistemi drejtësie të drejtë dhe inkurajues.

Së dyti, është vërejtur **një tendencë e dukshme për të shmangur oraret e planifikuara të seancave, duke çuar në agjenda të papërfunduara deri në fund të shumë seancave të udhëhequra nga gjyqtarë të ndryshëm.**¹⁷ Ka shumë raste kur gjyqtarët propozojnë një plan tjetër për procedurat e ditës, por nuk arrijnë ta përfundojnë atë deri në fund të ditës, duke lënë detyrat e papërfunduara për seancën e ardhshme të planifikuar. Për më tepër, disa seanca janë karakterizuar nga miratimi i kërkesave të pazakonta nga individët e akuzuar, të tilla si pauza për cigare, duke rezultuar në keqmenaxhimin e konsiderueshëm të kohës dhe çrregullim në sallën e gjyqit, shpesh të shoqëruar me shqetësime të tjera si zhurma.¹⁸ Kjo e nxitë dështimin për të ndarë kohën dhe burimet në mënyrë efikase, duke kontribuar në dëmtimin e pamjes më të gjerë të efektivitetit të gjykatës në trajtimin e rasteve të korrupsionit me prioritet të lartë.

Në të kundërtën, duhet theksuar megjithatë se **ka disa gjyqtarë që demonstrojnë respektimin e agjendave të paracaktuara dhe afateve procedurale**, duke minimizuar kështu mundësitë për kërkesa të papritura apo devijime procedurale. Këta gjyqtarë përdorin strategji proaktive, të tilla si caktimi i seancave të përqendruara në bllok që zgjasin një javë për të trajtuar në mënyrë sistematike të gjitha çështjet e provave dhe dëshmitë e dëshmitarëve.¹⁹ Për më tepër, ata planifikojnë seancat shumë përpara, duke siguruar kohë të mjaftueshme për mbrojtjen dhe prokurorinë për të përgatitur çështjet e tyre, duke minimizuar gjithashtu konfliktet e planifikimit që mund të lindin nga mosdisponueshmëria e mbrojtjes ose prokurorëve.²⁰ Qasje të tilla janë shumë efektive për zgjidhjen e shpejtë të rasteve dhe ato përfaqësojnë praktikën më të mira brenda sistemit gjyqësor.

Si përfundim, numri i lartë i seancave të anuluar ose të vonuara, mesatarisht 688 ditë (rreth 2 vjet) për zgjidhjen e rastit, nxjerr në pah sfida të rëndësishme që kontribuojnë në procedimet e zgjatura ligjore. Faktorë të tillë si moslëshimi i urdhrave të arrestit për të pandehurit që mungojnë, shpërndarja joadekuate e materialeve të rastit dhe kërkesat e paarsyeshme nga avokatët mbrojtës kontribuojnë në ndërprerjen e seancave dhe pengojnë dhënien në kohë të drejtësisë. Për më tepër, mospërputhjet e vërejtura brenda procedurave gjyqësore, duke përfshirë devijimet nga oraret e planifikuara të seancave dhe qasjet e njëanshme nga gjyqtarët ndaj përfaqësuesve ligjorë, pengojnë më tej efikasitetin e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit. Ndërsa strategjitë proaktive të përdorura nga disa gjyqtarë demonstrojnë praktika premtuese, nevoja për një qëndrueshmëri më të madhe dhe respektim të afateve kohore procedurale në të gjitha procedurat gjyqësore është evidente. Adresimi i këtyre sfidave kërkon përpjekje për të rritur përgjegjshmërinë, transparencën dhe saktësinë procedurale brenda sistemit gjyqësor.

16 Riger dhe të tjerët. "Paragjykimi gjinor në dinamikën e sallës së gjyqit." Ligji dhe sjellja njerëzore, 1995, f. 465–80. E qasshme në: <http://www.jstor.org/stable/1394196>

17 Fokus grupi i mbajtur me zyrtarët e monitorimit më 15 prill 2024

18 Po aty.

19 Në rastin e njohur si "Veteranët" ishin caktuar 25 deklarata të dëshmitarëve gjatë periudhës 26 shkurt - 1 mars 2024. Më shumë në: <https://drejtesiasot.com/archive/>

20 Fokus grupi i mbajtur me zyrtarët e monitorimit më 15 prill 2024

Kapitulli 2.

Rezultatet e Monitorimit të Aktgjykimeve

Ky kapitull përshkruan gjetjet nga procesi i monitorimit të aktgjykimeve nga GLPS dhe është i ndarë në tre seksione. Seksioni i parë paraqet të dhënat kryesore dhe njohuritë nga aktgjykimet e analizuara, duke përfshirë rajonet me vendimet më të publikuara, veprat mbizotëruese të korrupsionit, numrin e individëve të akuzuar dhe llojet e vendimeve. Dy seksionet e ardhshme eksplorojnë faktorë specifikë dhe tendencat në zhvillim. Seksioni i dytë shqyrton kohëzgjatjen e procedimeve ligjore për veprat penale të korrupsionit dhe treguesit përkatës. Pjesa e tretë trajton masat ndëshkuese të aplikuara në vendimet e fajësisë.

2.1. Gjetjet e Përgjithshme nga aktgjykimet e Monitoruara

GLPS ka monitoruar të gjitha aktgjykimet e publikuara në faqen zyrtare të KGJK-së gjatë kësaj periudhe vlerësimi. Nga këto aktgjykime, 143 i përkisnin kapitullit të korrupsionit të KPRK-së, duke përfshirë Nenet 414 deri në 430. Vëzhgimet kryesore nga ky proces monitorimi janë përshkruar më poshtë.

Bazuar në gjykimet e publikuara gjatë kësaj periudhe të monitorimit, Prishtina ka shënuar numrin më të madh me 43 aktgjykime të publikuara, e ndjekur nga Mitrovica dhe Gjilani me 25. Gjakova publikoi 16 aktgjykime, ndërsa Ferizaj dhe Prizreni kishin nga 12. Peja publikoi 11 aktgjykime.

Rajoni	Numri i aktgjykimeve të publikuara
Prishtina	43
Mitrovica	25
Gjilan	25
Gjakova	16
Ferizaj	12
Prizren	12
Peja	11

Shumica e këtyre aktgjykimeve trajtonin një vepër të vetme penale nga kapitulli i korrupsionit, me vetëm nëntë raste që përfshinin dy vepra, dhe dy raste që përfshinin tri vepra. Numri mesatar i personave të akuzuar për aktgjykim ishte dy, duke filluar nga një deri në 13 persona.

Ndër këto aktgjykime, vepra më e zakonshme ishte 'Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar' e paraqitur në 63 aktgjykime. Kjo u pasua nga 'Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave/të hyrave, dhuratave, përfitimeve të tjera materiale ose detyrimeve financiare' të gjetura në 40 gjykime. Gjithashtu, vepra penale "Dhënia e ryshfetit" është paraqitur në 20 aktgjykime.

Vepra Penale/Neni	Numri i Aktgjykimeve
Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar (Neni 414)	63
Abuzimi dhe mashtrimi në prokurimin publik (Neni 415)	7
Keqpërdorimi i informacionit zyrtar (Neni 416)	0

Konflikti i interesit (Neni 417)	6
Shpërdorimi në detyrë (Neni 418)	3
Mashtrimi në detyrë (Neni 419)	0
Shfrytëzimi i paautorizuar i pasurisë (Neni 420)	2
Marrja e ryshfetit (Neni 421)	8
Dhënia e ryshfetit (Neni 422)	20
Dhënia e ryshfetit zyrtarëve të huaj publikë ose personave zyrtarë të huaj (Neni 423)	0
Tregtimi i ndikimit (Neni 424)	1
Nxjerrja e vendimeve gjyqësore të paligjshme (Neni 425)	1
Zbulimi i sekreteve zyrtare (Neni 426)	0
Falsifikimi i dokumenteve zyrtare (Neni 427)	3
Mbledhja dhe pagesat e paligjshme (Neni 428)	1
Përvetësimi i paligjshëm i pasurisë gjatë kontrollit ose ekzekutimit të një vendimi gjyqësor (Neni 429)	0
Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave/ të hyrave, dhuratave, përfitimeve të tjera materiale ose detyrimeve financiare (Neni 430)	40

Numri i personave të akuzuar gjatë kësaj periudhe ishte 217. Nga ky numër, gratë përbënin 17 për qind (37 gjithsej), ndërsa burrat përbënin 83 për qind të mbetur (187 gjithsej). Kjo tregon një pabarazi të konsiderueshme gjinore midis individëve të implikuar në rastet e korrupsionit në sistemin gjyqësor.

Numri i personave të akuzuar	225
Gra	37
Burra	180

Ndër aktgjykimet e monitoruara, 89 prej tyre përmbanin aktgjykime dënuese, 43 ishin aktgjykime liruese, dhe 17 ishin refuzuese.²¹

Lloji i aktgjykimeve	Numri i aktgjykimeve
Aktgjykime dënuese	89
Aktgjykime liruese	43
Aktgjykime refuzuese	17

Gjithsej 128 persona u arrestuan për korrupsion, 72 u shpallën të pafajshëm dhe 29 morën vendime refuzuese. Për sa i përket gjinisë, 19 gra u dënuan në krahasim me 101 burra të dënuar, 13 gra u shpallën të pafajshme në krahasim me 59 burra, ndërsa aktgjykime refuzuese vendime u nxorrën për 5 gra dhe 24 burra.

Një konstatim nga procesi i monitorimit është se **shumica e aktgjykimeve nuk specifikojnë dëmet në buxhetin e shtetit, apo përfitimet e paligjshme të zyrtarëve publikë**. Konkretisht, në 125 vendime, të cilat përbëjnë 87 për qind të rasteve, gjyqtarët nuk dhanë detaje për dëmin financiar të shkaktuar nga veprat penale të korrupsionit apo përfitimet e paligjshme të bëra nga pushtetarët. Ky lëshim paraqet sfida të rëndësishme për analizimin dhe kuptimin e masave ndëshkuese të zbatuara në këto raste. Mungesa e dhënies së detajeve për ndikimin financiar mund të pengojë vlerësimin e duhur nëse dënimet janë proporcionale me ashpërsinë e krimeve.

²¹ Shuma nuk korrespondon me 143 aktgjykimet e monitoruara, pasi kishte katër aktgjykime që përmbanin edhe aktgjykime fajësie edhe liruese, dhe dy të tjera që përmbanin edhe aktgjykime refuzuese dhe liruese (për individë të ndryshëm ose për vepra të ndryshme).

Për më tepër, **sekuestrimit apo konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme është hasur në vetëm 11 nga 89 aktgjykime dënuese**, që përfaqësojnë afërsisht 8 për qind të rasteve. Vetëm në njërin prej këtyre rasteve pasuria e konfiskuar korrespondonte me dëmin e shkaktuar, ndërsa në dhjetë rastet e mbetura shumat e konfiskuara ishin shumë minimale. Specifikimi dhe sigurimi i konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme në çdo gjykim është thelbësor për disa arsye. Ai mund të shërbejë si një parandalues kundër korrupsionit, duke sinjalizuar se vepra të tilla do të rezultojnë në pasoja të konsiderueshme financiare. Për më tepër, përmes sekuestrimit apo konfiskimit të kësaj pasurie promovohet transparenca dhe llogaridhënia, duke demonstruar se gjyqësori është i përkushtuar për të trajtuar tërësisht aspektet financiare të korrupsionit. Nëpërmjet synimit të përfitimeve financiare të individëve të korruptuar, sistemi gjyqësor mund të bëjë përpjekje më efikase në parandalimin e korrupsionit dhe për të forcuar besimin e publikut në aftësinë e tij për të mbështetur drejtësinë.

Së fundi, **gjykatat nuk po e respektojnë afatin e publikimit të aktgjykimeve në faqen zyrtare të KGJK-së**. Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2019 përcakton afatin prej 60 ditësh për publikimin e aktgjykimeve në faqen zyrtare të KGJK-së.²² Megjithatë, gjatë procesit të monitorimit janë hasur shumë raste për të cilat aktgjykimet janë publikuar shumë vite pas marrjes së vendimit përfundimtar. Kjo vonesë në publikim dëmton transparençën dhe llogaridhënien e procesit gjyqësor. Publikimi në kohë i vendimeve është thelbësor për ruajtjen e besimit të publikut në sistemin ligjor, sigurimin e informacionit të nevojshëm për profesionistët ligjorë dhe për të siguruar që drejtësia e zbatuar të vihet në pah.

2.2. Ndërlidhja në mes të Kohëzgjatjes së Procedurës dhe Treguesve të Tjerë

Një vëzhgim domethënës nga procesi i monitorimit të vendimeve është kohëzgjatja tipike dhe mesatarja²³ e procedurave për zgjidhjen e rasteve të korrupsionit në gjykata. Për të matur çdo kohëzgjatje të procedurës, është llogaritur diferenca ndërmjet datës së vendimit përfundimtar dhe datës së kohëzgjatja mesatare e procedurës ishte **688 ditë (pothuajse 2 vjet)**, ndërsa një procedurë tipike **zgjatë 486 ditë**. Rasti me kohëzgjatjen më të gjatë ishte 3259 ditë (rreth 9 vjet).²⁴ Pas analizimit të kryqëzuar të variablave, u zbulua se disa tregues lidhen me kohëzgjatjen e procedurës.

Së pari, u vu re se **kohëzgjatja ndryshonte ndjeshëm në varësi të vendimit të rastit**. Konkretisht, procedura tipike e cila rezultoi me aktgjykime dënuesë zgjati 184 ditë. Megjithatë, kjo kohëzgjatje u rrit dukshëm në aktgjykimet liruese, që zakonisht zgjasin 864 ditë (pothuajse 2 vjet e gjysmë) dhe arriti kulmin në aktgjykimet refuzuese në 1205 ditë. Për më tepër, kohëzgjatja ishte dukshëm më e lartë për rastet e izoluara që përfshinin aktgjykime liruese dhe refuzuese, me një procedurë tipike prej 1,079 ditësh (rreth 3 vjet), dhe gjykimet në aktgjykimet dënuese dhe liruese, me 1,437 ditë (pothuajse 4 vjet). Megjithëse dy skenarët e fundit mund t'i atribuohen kompleksitetit të vendimeve dhe përfaqësojnë një madhësi mostre shumë më të vogël, dallimi midis tre të parave mbetet shqetësues. Ky trend sugjeron që procedurat e zgjatura kanë tendencë të rezultojnë në aktgjykime liruese ose refuzuese.

22 Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2019, Neni 8. E qasshme në: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/79875_Udhezim_Administrativ_Nr_04_2019_per_Publikimin_Aktgjykimeve_te_Perpunuara_dhe_Manual_per_Publikimin_dhe_Perpunimin_Aktgjykimeve.pdf

23 Procedura tipike përfaqësohet nga mediana, pasi të dhënat janë të shpërndara. Megjithatë, është përdorur edhe mesatarja (mesatarja aritmetike). Kohëzgjatja mesatare, e llogaritur duke mbledhur të gjitha kohëzgjatjet e procedurës dhe pjesëtuar me numrin e rasteve, ofron një ide të përgjithshme se sa kohë zgjasin rastet mesatarisht. Kohëzgjatja tipike është vlera e mesme në vargun e të gjitha gjatësive të procedurave, të rregulluara nga më e shkurtra tek më e gjata, dhe përfaqëson rastin "tipik" të paprekur nga periferitë. Përdorimi i të dyja vlerave ofron një pamje të plotë: mesatarja tregon tendencat e përgjithshme, ndërsa mediana thekson përvojën tipike për shumicën e rasteve. Kjo qasje e dyfishtë siguron një kuptim të ekuilibruar të gjatësisë së procedurës.

24 Aktgjykimi është i qasshëm këtu: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PR_PKR_2019-092321_SQ.pdf

Lloji i aktgjykimit	Numri i aktgjykimeve	Kohëzgjatja Mesatare e Procedurës (në ditë)	Kohëzgjatja Tipike e Procedurës (në ditë)
Dënues	85	406	184
Lirues	37	971	864
Refuzues	15	1343	1205
Lirues dhe refuzues	2	1079	1079
Dënues dhe lirues	4	1325	1437
Gjithsej	143	688	486

Së dyti, **rajone të ndryshme kanë kohëzgjatje dukshëm të ndryshme të procedurave**. Prishtina kryeson listën e gjykatave me kohëzgjatje më të gjatë, me një procedurë tipike që zgjat 633 ditë. Pas Prishtinës, Prizreni dhe Gjakova kanë mesatarisht një kohëzgjatje prej 595 ditë dhe 571 ditë. Nga ana tjetër, Gjilani ka kohëzgjatjen më të shkurtë të procedurës tipike, me një kohëzgjatje tipike prej 241 ditësh. Këto pabarazi thelbësore ndërmjet rajoneve nxjerrin në pah joefikasitetin brenda sistemit gjyqësor. Mesatarja më e gjatë e Prishtinës mund t'i atribuohet kryesisht trajtimit të një vëllimi dukshëm më të madh të lëndëve penale në krahasim me gjykatat e tjera.²⁵ Në ana tjetër, përderisa Mitrovica dhe Gjilani kanë numër të ngjashëm të aktgjykimeve të publikuara, ato kanë një dallim të dukshëm në efikasitet. Këto pabarazi theksojnë nevojën që gjykatat të rrisin efektivitetin e tyre në zgjidhjen e shpejtë të rasteve të korrupsionit. Për më tepër, këto gjetje theksojnë gjithashtu potencialin për efikasitet më të madh brenda gjykatës për të përsheptuar zgjidhjen e rasteve të korrupsionit.

Rajoni	Kohëzgjatja Mesatare e Procedurës (Në ditë)	Kohëzgjatja Tipike e Procedurës (Në ditë)
Prishtinë	992	633
Pejë	700	447
Prizren	671	595
Mitrovicë	657	517
Gjakovë	623	571
Ferizaj	483	516
Gjilan	362	241

Së treti, siç pritej, **kohëzgjatja e trajtimit të rasteve priret të jetë më e gjatë kur në procedurë përfshihen vepra të shumta të korrupsionit**. Pavarësisht nga madhësia relativisht e vogël e mostrës prej 11 gjykimesh duke trajtuar disa vepra të korrupsionit në krahasim me 133 vendimet që kanë të bëjnë me një vepër të vetme, dallime domethënëse ishin evidente. Konkretisht, kohëzgjatja mesatare e procedurës për rastet që përfshijnë më shumë se një shkelje ishte 611 ditë, më e gjatë se procedura tipike për një rast të vetëm korrupsioni, e cila zgjat 466 ditë.

	Numri i aktgjykimeve	Kohëzgjatja Mesatare e Procedurës (Në ditë)	Kohëzgjatja Tipike e Procedurës (Në ditë)
Një vepër korrupsioni	132	673	466
Më shumë se një vepër korrupsioni	11	822	611

FourthFFouTop of Form

²⁵ Raporti Statistikor i KGJK-së 2023. I qasshëm në: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/1682_KGJK_Raporti_Statistikor_Gjykatave_Vjetori_2023.pdf

Së katërti, **ka një ndryshim të dukshëm në gjatësinë e procedurave tipike për vepra të ndryshme të korrupsionit**. Në vlerësimin e korrelacioneve të mundshme ndërmjet kohëzgjatjes së procedurave dhe veprave penale specifike, fokusi u vendos në analizimin e tri veprave më të përhapura në mostrën e aktgjyqimeve. Veçanërisht, kishte ndryshime të konsiderueshme në kohëzgjatjen mesatare të procedurave të lidhura me secilën vepër. Për shembull, vepra penale 'Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar', u dallua me kohëzgjatjen mesatare më të gjatë të procedurës, që kërkon rreth 873 ditë për të marrë një vendim përfundimtar. Në të kundërt, vepra e dytë më e zakonshme, 'Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave/të hyrave, dhuratave, përfitimeve të tjera materiale ose detyrimeve financiare', shfaqti kohëzgjatjen tipike më të shkurtër të procedurës me vetëm 163 ditë. Ndërkohë, vepra penale "Dhënia e ryshfetit", ka një kohëzgjatje mesatare të procedurës prej 531 ditësh. Këto pabarazi sugjerojnë se vepra të ndryshme të korrupsionit sjellin ndërlikime të dallueshme dhe kërkesa provash, duke ndikuar kështu në kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave të korrupsionit. Megjithatë, kohëzgjatja dukshëm e prolonguar e lidhur me veprën më të shpeshtë të përshkruar në nenin 414 ngre përsëri shqetësime në lidhje me efektivitetin e gjykatës në trajtimin e menjëhershëm të rasteve të korrupsionit.

Vepra	Numri i aktgjyqimeve	Kohëzgjatja mesatare e procedurës (Në ditë)	Kohëzgjatja tipike e procedurës (Në ditë)
Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar (Neni 414)	60	1070	873
Dhënia e ryshfetit (Neni 422)	20	574	531
Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave/ të hyrave, dhuratave, përfitimeve të tjera materiale ose detyrimeve financiare (Neni 430)	39	255	163

Analiza e rezultateve të monitorimit të seancave gjyqësore nga korriku 2023 deri në mars 2024 nxjerr në pah sfida të mëdha sistematike që kontribuojnë në procedurat e zgjatura ligjore në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Kohëzgjatja mesatare prej 688 ditësh për zgjidhjen e rasteve, nxjerr në pah nevojën urgjente për trajtim më të shpejtë të rasteve të tilla. Veçanërisht shqetësuese është korrelacioni ndërmjet procedurave të zgjatura dhe gjyqimeve të lirit ose refuzimit, gjë që tregon se procedurat e zgjatura tentojnë të rezultojnë në lirime ose refuzime. Për më tepër, fakti që vepra më e zakonshme, 'Keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar', ka gjithashtu mesataren më të gjatë, nënkupton se gjykata përballlet me sfida në zgjidhjen e menjëhershme të rasteve që lidhen me këtë vepër, që mund të rezultojë në vonesa në administrimin e drejtësisë dhe ngecje edhe për vepra të tjera. Këto gjetje, në lidhje me vëzhgimin e keqmenaxhimit të seancave, të paraqitura në kapitullin e mëparshëm, shfaqin potencialin e vërtetë që gjykatat mund t'a kenë për t'i trajtuar më shpejt çështjet e korrupsionit.

2.3. Masat ndëshkuese

Nga 143 aktgjyqime të monitoruara, siç u përmend më herët, 89 rezultuan me aktgjykim dënues. Nga këto 89 aktgjyqime, 67 kanë qenë dënime kryesore, ndërsa 21 dënime alternative. Ka pasur edhe një rast për të cilin është dhënë vërejtje gjyqësore.

Llojet e aktgjyqimeve	Numri i aktgjyqimeve
Dënime kryesore	67
Dënime alternative	21
Vërejtje gjyqësore	1

Gjobat ishin forma më e përhapur e dënimeve kryesore, duke përbërë 75 për qind të totalit të dënimeve kryesore. Midis tyre, ka pasur nëntë raste me burgim, 51 raste me gjobë, gjashtë raste me burgim dhe gjobë, dhe një rast me gjobë të shoqëruar me dënim me kusht. Për më tepër, ndër 67 rastet kur individët u shpallën fajtorë, dënimi plotësues në formën e ndalimit të ushtrimit të funksioneve të administratës publike ose të shërbimit publik u shqiptua vetëm në 20 raste. Në 47 rastet e mbetura, pavarësisht dënimeve për korrupsion, asnjë dënim i tillë nuk u administrua.

Llojet e dënimeve	Numri i aktgjyqimeve
Dënim me burg	9
Dënim me burg dhe gjobë	6
Dënim me gjobë	51
Gjobë dhe dënim me kusht	1
Totali	67

Tri dënimet kryesore më të larta të administruara përfshinin dënime për dy individë të cilët morën secili nga 4.7 vjet burgim, 16,000 euro gjobë dhe 4 vjet ndalim për ushtrimin e ndonjë funksioni publik, të dënuar sipas nenit 414 dhe 430 të KPRK-së. Dy persona të tjerë janë dënuar me 5.5 vjet burgim, 1000 euro gjobë dhe 6 vjet ndalim për mbajtjen e pozitave në shërbimin publik nga neni 414 KPRK dhe neni 430 KPRK. Gjithashtu, dy persona u dënuan me 5 vjet burgim dhe 2 vjet ndalim për të kryer ndonjë rol në shërbimin publik, me dënimet e tyre bazuar në nenin 414 të KPRK-së.²⁶

Tri dënimet kryesore më të ulëta, të gjitha lidhur me nenin 430 të KPRK-së, përfshinin 150 euro gjobë për një individ dhe 200 euro gjobë për dy persona të veçantë në raste të ndryshme. Dy persona të tjerë të veçantë morën secili nga 150 euro gjobë.

Analizimi i masave ndëshkuese për veprat penale nga nenet 414, 422 dhe 430 të KPRK-së, duke pasur parasysh numrin më të madh të aktgjyqimeve të disponueshme për këto vepra, vë në pah reagimin gjyqësor ndaj korrupsionit.²⁷ Megjithatë, masat ndëshkuese janë të lidhura ngushtë me dëmin e shkaktuar nga vepra penale, e cila në 87 për qind të aktgjyqimeve të analizuar nuk është specifikuar. Pavarësisht këtij kufizimi, të dhënat e disponueshme për veprat penale të nenit 414, 422 dhe 430 janë përmbledhur në paragrafët e mëposhtëm.

Masat ndëshkuese për veprat penale të korrupsionit nga neni 414 i KPRK-së parashikojnë se zyrtari i cili keqpërdor pozitën e tij për të përfituar dobi ose për të shkaktuar dëm mund të dënohet me burgim nga një deri në tetë vjet.²⁸ Nëse përfitimi ose dëmi i kalon 5000 euro, dënimi përfshin gjobë dhe burgim nga tre deri në dhjetë vjet.²⁹ Nga analiza e aktgjyqimeve nga neni 414 rezulton se nga 63 aktgjyqime, 20 kanë rezultuar me aktgjykim fajtor. Ndër to, 18 përfshinin dënime kryesore, 8 me burgim dhe 9 me gjobë. Për më tepër, dy raste përfshinin dënime alternative. Të dhënat tregojnë se 13 persona janë dënuar me burgim mesatarisht 2.43 vjet, ndërsa 13 persona të tjerë janë dënuar me gjobë, me gjobë mesatare prej 4860 euro. Këto shifra nxjerrin në pah gamën e masave ndëshkuese të aplikuara dhe dënimet relativisht të moderuara të vendosura për vepra të rënda që përfshijnë dëme të konsiderueshme financiare.

Neni 422 i KPRK-së përcakton se individët të cilët premtojnë, ofrojnë ose japin ndonjë dhuratë apo përfitim të padrejtë për zyrtarët mund të dënohen me gjobë dhe burgim deri në pesë vjet.³⁰ Nëse vepra rezulton me përfitim që tejkalon 15,000 euro, dënimi mund të përfshijë edhe burgim nga një deri në tetë vjet, përveç gjobës.³¹ Duke analizuar aktgjykimet sipas nenit 422, kemi konstatuar se nga 18 raste,

²⁶ Rasti nr. 2019:084677, i qasshëm në: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PR_PKR_2019-084677_SQ.pdf

²⁷ Shiko Kapitullin 2.1

²⁸ KPRK, Neni 414 para 1

²⁹ KPRK, Neni 414 para 2

³⁰ KPRK, Neni 422 paras 1-2

³¹ KPRK, Neni 422 para 3

13 kanë rezultuar me aktgjykim denues. Prej tyre, 6 persona kanë marrë dënime kryesore, ndërsa 7 kanë marrë dënime alternative. Një rast kishte të bënte me burgim dhe gjobë, ndërsa pjesa tjetër u gjobit. Dënimi i bashkuar me burgim dhe gjobë arriti në 8 muaj e 10 mijë euro. Duke përjashtuar këtë rast, gjoba mesatare ishte 1117 euro.

Neni 430 i Kodit Penal trajton detyrimin për deklarimin e pasurisë, të ardhurave, dhuratave dhe informacioneve të tjera financiare. Dështimi për të paraqitur deklarata të tilla mund të rezultojë në gjobë ose burgim deri në tre vjet.³² Nëse një person falsifikon ose heq informacionin e kërkuar në deklaratë, ai mund të përballet me gjoba dhe burgim që variojnë nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.³³ Duke analizuar aktgjykimet nga neni 430, kemi konstatuar se nga 40 lëndë, 37 kanë përfunduar me aktgjykim fajtor. Prej tyre, 26 persona kanë marrë dënime kryesore, 10 kanë marrë dënime alternative dhe një ka marrë vërejtje gjyqësore. Nuk u shqiptuan dënime me burgim si dënime kryesore dhe të gjithë individët u gjobitën. Gjoba mesatare ishte 527 euro.

Kapitulli 3.

Rastet e profilit të lartë

Ky kapitull ofron një përmbledhje koncize të mbarëvajtjes së gjyqimeve të katër rasteve të profilit të lartë të gjykuara gjatë kësaj periudhe. Nga këto raste janë identifikuar tendencat dhe sfidat në procedurat gjyqësore të rasteve të korrupsionit të profilit të lartë.

Në rastin e parë, të njohur si "**53 milionshi**", Pal Lekaj, Nebih Shatri, Eset Berisha dhe Besim Tahiri janë akuzuar për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar. Pal Lekaj, asokohe ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, së bashku me Nebih Shatrin, ish-sekretar i përgjithshëm në të njëjtën ministri, dhe Besim Tahiri, drejtor i Departamentit të Prokurimit Publik, akuzohen për shkaktrim të dëmit financiar në buxhetin e Republikës së Kosovës, në vlerë prej përafërsisht **38 milionë euro**, përmes një marrëveshjeje të kundërligjshme të nënshkruar në vitin 2017. Aktakuza është ngritur më 4 shkurt 2022, ndërsa gjykimi ka filluar më 20 prill 2022, në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Special. E gjithë procedura ka pasur gjithsej 23 seanca dhe ka zgjatur **726 ditë (rreth 2 vjet)**, me aktgjykim të formës së prerë më 31 janar 2024. Gjykata Themelore e Prishtinës i **shpalli fajtorë të gjithë të pandehurit** dhe i dënoi me gjithsej **10.2 vjet burgim**.³⁴ Përkatësisht, ish-ministri Pal Lekaj është dënuar me 3 vjet e 8 muaj burgim efektiv, së bashku me 3 vjet e 6 muaj ndalim të ushtrimit të funksionit publik. Nebih Shatri dhe Besim Tahiri u dënuan të dy me 1 vit e 8 muaj burgim, me 2 vjet ndalim për të ushtruar funksione publike, ndërsa Eset Berisha me 3 vjet e 3 muaj burg, së bashku me 3 vjet ndalim nga zyra publike.

Në rastin e dytë, i njohur si "**Stenta 2**", 37 mjekë të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), akuzohen për veprën penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar", vepra e supozuar ka ndodhur në periudhën prej datës 1 janar 2011 dhe 31 dhjetor 2015. Sipas aktakuzës së lëshuar më 15 qershor 2016, këta persona, me detyrën e mjekëve në Klinikën e Kardiologjisë në QSHSK, kanë keqpërdorur pozitën e tyre duke u lëshuar letra për mjekim jashtë institucioneve shëndetësore publike për të paktën 233 persona, edhe pse kanë kryer të njëjtat trajtime mjekësore, për të mundësuar rimbursimin nga Ministria e Shëndetësisë për trajtimin mjekësor në institucionet private. Dëmi i pretenduar i shkakuar në buxhetin e Kosovës është vlerësuar në rreth **katër milionë euro**. Departamenti i Posaçëm, duke filluar në shkurt 2018. Kjo procedurë ka qenë jashtëzakonisht e gjatë, ka zgjatur **2698 ditë (rreth 7 vjet e gjysmë)**, gjatë gjithë periudhës së monitorimit, janë mbajtur 4 seanca, pa asnjë shkelje). Gjykata dha vendimin përfundimtar, më 20 shtator 2023, duke rezultuar

32 KPRK, Neni 30 para 1

33 KPRK, Neni 30 para 2

34 <https://drejtesiasot.com/2024/01/31/shpallet-aktgjykimi-ne-rastin-e-pal-lekaj-dhe-te-tjereve/>

në lirim e të gjithë personave të akuzuar për mungesë provash. Në një shënim tjetër, për njërin nga të pandehurit, Daut Goranin, procedura ishte ndarë nga procedura fillestare. Megjithatë, ai u shpall i pafajshëm edhe për mungesë provash, më 4 dhjetor 2023.³⁵

Në rastin e tretë, "**Ukë Rugova dhe të tjerët 1&2**", të akuzuarit u akuzuan për krim të organizuar dhe kontrabandë me migrantë gjatë viteve 2011 dhe 2014. Ukë Rugova, i pandehuri kryesor, akuzohej për menaxhim të një grupi kriminal që lehtësonte marrjen e vizave Shengen të BE-së përmes mjete të paligjshme apo korrupsion. Individët e akuzuar përfshinin ish-zyrtarë të qeverisë. Aktakuza është ngritur më 16 maj 2016, ndërsa gjykimi ka filluar më 30 gusht 2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Gjatë rrjedhës së procedurës, procedura u nda në dy pjesë (1 dhe 2), ku personat e profilit të lartë po gjykoreshin në rastin Ukë Rugova 1. Aktgjykimi për personat e profilit të lartë, u shpall më 30 mars 2023, pas një procesi **2453-ditor, e lroi Rugovën dhe të tjerët nga akuzat për krim të organizuar**, por i shpalli ata fajtorë për armëmbajtje pa leje. Rugova është dënuar me 6000 euro gjobë, ndërsa dy të pandehur të tjerë janë gjobitur me 3500 euro dhe akuzat e një të pandehuri tjetër janë refuzuar.

Në rastin e katërt, të njohur si "**Gylenistët**", Driton Gashi, Valon Krasniqi dhe Rahman Sylejmani akuzohen për vepra të ndryshme penale, duke përfshirë veprën "Keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar" nga kapitulli i korrupsionit. Veprat e supozuara kanë ndodhur nga 23 mars 2018 deri më 29 mars 2018 në Prishtinë, Driton Gashi, si Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, akuzohet për dëbimin e paligjshëm të shtetasve turq nga Kosova dhe dorëzimin e tyre tek autoritetet turke; Rahman Sylejmani i akuzuar për dhënien e urdhrave për dëbim të detyruar të shtetasve turq, Valon Krasniqi, drejtor i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim, dyshohet se i ka hequr lejet e qëndrimit të ligjshëm në kundërshtim me ligjin Republika e Kosovës, dhe gjykimi filloi më 9 shkurt 2022 në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Special. Me aktgjykimin e datës 19 korrik 2023, Driton Gashi **u shpall fajtor** për "Keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar" dhe **dënuar me 4 vjet dhe 8 muaj burg**, me 4 vjet ndalim shtesë nga funksionet e administratës publike, së bashku me pagesën e tarifave gjyqësore. Valon Krasniqi dhe Rahman Sylejmani **u shpallën të pafajshëm** për mungesë provash. Procedura zgjati 876 ditë. Procedura në shkallën e parë ka përfunduar.

Analiza e këtyre katër rasteve nënvizon disa vëzhgime. Së pari, **kohëzgjatja e procedurave gjyqësore ishte tepër e gjatë, duke tejkaluar dukshëm afatet kohore tipike**. Kjo zgjatje në trajtimin e korrupsionit të profilit të lartë ngre shqetësime lidhur efikasitetin e sistemit gjyqësor në trajtimin e rasteve komplekse të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Një gjë e tillë u vërejt nga Act Now edhe për raste të tjera të profilit të lartë dhe lidhet gjithashtu me arsyet e përmendura në Kapitullin 1 më lartë.³⁶

Së dyti, **vetëm një nga gjykimet përfundoi me aktgjykim dënues, ndërsa një rast tjetër u përbyll me aktgjykim dënues të pjesshëm**. Në të kundërt, dy raste të tjera, të cilat përfshinin një numër të konsiderueshëm personash të akuzuar, përfunduan me shpalljen e pafajshme të akuzuarve. Së treti, **të gjitha vendimet liruese janë shpallur në bazë të provave të pamjaftueshme**. Mbizotërimi i aktgjyqimeve liruese për shkak të provave të pamjaftueshme vë në pikëpyetje tërësinë e hetimeve dhe standardet e provave të aplikuara në këto raste.

Një pikë tjetër me rëndësi është se në rastin "53 milionshi", **u shqiptua një dënim dukshëm minimal**, veçanërisht duke pasur parasysh dëmin e konsiderueshëm financiar të shkaktuar në buxhetin e shtetit. Neni 414 i KPRK-së, për të cilin të pandehurit janë shpallur fajtorë, specifikon se zyrtari i shpallur fajtor për vepra që kanë rezultuar në dëmshpërbim mbi pesë mijë euro, i nënshtrohet dënimit me burg prej tre deri në dhjetë vjet.³⁷ Në rastin në fjalë, ish-ministri Lekaj u dënuar me vetëm 3 vjet e 8 muaj, ndërsa dy të akuzuarit e tjerë u akuzuan me nga 1 vit e 8 muaj burgim, për një dëm prej 38 milionë eurosh. Kjo pabarazi midis peshës së veprave penale dhe dënimeve thekson mangësitë e mundshme në udhëzimet e dënimit ose në diskrecionin gjyqësor për individët e profilit të lartë.

³⁵ <https://drejtesiasot.com/2023/12/04/lirohet-i-akuzuari-per-korrupsion-ne-rastin-stenta-2/>

³⁶ Fokus grupi i mbajtur me zyrtarët e monitorimit më 15 prill 2024

³⁷ KPRK, neni 414 paragrafi 2, aksesuar në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>

Rekomandimet:

Për të ngritur efikasitetin dhe për të zvogëluar anulimet dhe vonesat e seancave:

- Gjykatat duhet të marrin masat e nevojshme kur palët nuk paraqiten në seancë, ose nuk respektojnë detyrimet e tyre ligjore për të komunikuar informacione të rëndësishme, siç janë shkresat e lëndës.
- Gjykatat duhet të zbatojnë rregullat për sigurimin e pjesëmarrjes së të pandehurve në mënyrë rigorozë, duke lëshuar urdhra arresti për të pandehurit që mungojnë siç kërkohet me ligj.
- Gjykatat duhet të zbatojnë praktikatat më të mira të planifikimit dhe të sigurojnë që personeli kyç dhe të gjitha aspektet teknike të jetë i disponueshëm dhe i gatshëm për seancat gjyqësore.
- Gjyqtarët dhe gjykatat duhet të sigurojnë planifikimin e duhur të seancave dhe respektimin e plotë të orareve të paracaktuara, për të arritur efikasitetin maksimal në trajtimin e rasteve të korrupsionit.
- Gjyqtarët duhet të praktikojnë shembuj të mirë të caktimit të mëhershëm të seancave, të tilla si caktimi i seancave të përqendruara në një kohë të caktuar kur është e mundur, ose planifikimi i një orari të gjitha seancave në fillim të një procedure.
- Gjykatat duhet të dokumentojnë dhe të ndajnë publikisht arsyet e anulimeve dhe vonesave të seancave.

Për të përmirësuar transparencën, përgjegjshmërinë dhe integritetin e procesit gjyqësor:

- Gjyqtarët duhet të sigurojnë një qasje të paanshme ndaj të gjitha palëve të përfshira në procedurë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet.
- Gjyqtarëve duhet t'u kërkohet të specifikojnë dëmet financiare ndaj buxhetit të shtetit dhe përfitimet e paligjshme të bëra nga zyrtarët publikë përmes kryerjes së veprave penale të korrupsionit. Kjo do të përmirësojë analizën e masave ndëshkuese dhe do të sigurojë që dënimet të jenë proporcionale me ashpërsinë e krimeve.
- Gjyqtarët duhet të specifikojnë pasurinë e konfiskuar ose të sekuestruar në aktgjykimet dënuese për të garantuar transparencën dhe efektivitetin e këtyre masave, në mënyrë që të sigurojnë një regjistrim të qartë të pasojave financiare ndaj kryerësve të veprave penale të korrupsionit.
- Gjyqtarët duhet të vendosin masa më adekuate ndëshkuese dhe të shtojnë dënime plotësuese, të tilla si ndalimet e ushtrimit të funksioneve publike. Kjo është e rëndësishme për të parandaluar shkeljet e ardhshme, për të siguruar llogaridhënien dhe për të rivendosur besimin e publikut në integritetin e institucioneve publike.



Funded by
the European Union

*Traftimi institucional
i rasteve të korrupsionit:*
Sfidat e sistemit gjyqësor
gjatë një viti



Group for Legal
and Political
Studies